



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Nr. 12462 Prot.,

Durrës më 25/7/2019

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

PËR PROMOVIMIN E TURIZMIT TË PESHKIMIT NË ZONËN E DurrësIT

Hyrje

Duke marrë parasysh presionet mjedisore që ndikojnë drejtpërdrejt në sektorin dhe veprimtaritë tradicionale të peshkimit, si rreziqet klimatike të lidhura me ndryshimet klimatike dhe reduktimin drastik të burimeve të peshkut;

Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe pasigurinë në rritje të kornizës administrative dhe ligjore për ndërmarrjet e peshkimit;

Duke marrë parasysh presionet sociale dhe ekonomike që prekin peshkatarët, të tilla si reduktimi dhe ndryshueshmëria e lartë e të ardhurave të tyre dhe struktura demografike e popullsisë së tyre;

Duke marrë parasysh ndikimet e turizmit masiv në zonën e Mesdheut dhe nevojat e formave alternative të qëndrueshme të turizmit;

Duke marrë parasysh që aktivitetet e peshkimit artizanal dhe tradicional përbëjnë një trashëgimi të rëndësishme kulturore në zonën e Mesdheut, por ende nuk janë njohur, mbrojtur ose vlerësuar;

Duke pasur parasysh se tregu i turizmit mund të përbëjë një mundësi ekonomike për diversifikimin e sektorit të peshkimit dhe kompanive;

Duke pasur parasysh se ekziston një “mundësi efektive” për zhvillimin e aktiviteteve të peshkimit rekreativ të propozuara nga kompanitë turistike që konkurojnë drejtpërdrejt me aktivitetet e turizmit të peshkimit të propozuara nga peshkatarët profesionistë;

Duke marrë parasysh rezultatet pozitive të aktiviteteve pilot të zbatuara dhe të testuara gjatë projektit TURISMED;

Palët nënshkruese kanë miratuar këtë Memorandum Mirëkuptimi mbi Turizmin e Peshkimit me qëllim që të sigurojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të produkteve dhe aktiviteteve të turizmit të peshkimit.

Synimi dhe qëllimi

Palët nënshkruese kanë si qëllim të përbashkët dhe synojnë promovimin e aktiviteteve të turizmit të peshkimit në zonën e Durrësit.

Turizmi i peshkimit konsiderohet si një grup aktivitetsesh që lidhen me turizmin, të kryera nga peshkatarët profesionistë, për të diferencuar të ardhurat e tyre, për të promovuar dhe zhvilluar me tej profesionin e tyre, si dhe një trashëgimi kulturore territoriale sociale dhe për të përmirësuar një përdorim të qëndrueshëm të ekosistemeve detare. Këto aktivitete përfshijnë: monitorimin e metodave tradicionale të peshkimit, rrefime dhe guida nga peshkatarët.

Palët nënshkruese miratuan këtë Memorandum të Mirekuptimit të turizmit të peshkimit në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të produkteve dhe aktiviteteve të turizmit të peshkimit.

Përfitimet e pritura

Përfitimet e pritura nga promovimi i aktiviteteve të llojit të turizmit të peshkimit janë të lidhura me çështje mjedisore dhe socio-ekonomike.

Nga pikëpamja socio-ekonomike, ajo mund të kontribuojë në:

- diversifikimi i aktiviteteve dhe të ardhurave nga peshkimi profesional;
- diversifikimi i ofertës turistike;
- Rritja e vlerës së shtuar të produkteve të peshkimit, veçanërisht të llojeve jo-komerciale;
- një kuptim më të mirë të vlerës dhe çmimit të produkteve të peshkut nga këndvështrimi i konsumatorit;
- transmetimi i profesionit tek të rinjtë;

Nga pikëpamja mjedisore, ajo mund të kontribuojë në:

- Zvogëlimin e presionit mbi burimet e peshkut,
- Zhvillimi, promovimi dhe rritja e praktikave të peshkimit profesional ekologjik,
- Zhvillimin, promovimin dhe avancimin e formave alternative të turizmit.

Palët nënshkruese gjithashtu konsiderojnë se zhvillimi i aktiviteteve të tilla turistike të peshkimit mund të kontribuojë drejtpërsëdrejti në ruajtjen dhe konsolidimin e sektorit tradicional të peshkimit artizanal përmes njohjes së mallrave dhe shërbimeve mjedisore të kryera nga peshkatarët profesionistë. Në fakt, zona detare dhe bregdetare (zona publike detare) duhet të konsiderohet pjesë integrale e një ekosistemi social-territorial; si pasojë,

peshkatarët që praktikojnë peshkimin tradicional dhe artizanal duhet të konsiderohen si

aktorët kryesorë për ruajtjen dhe përmirësimin e “peisazhit dhe burimeve të detit”, ashtu si bujqësia është garanci për ruajtjen dhe rritjen e peisazheve rurale dhe burimeve. Nga kjo pikëpamje, zhvillimi i aktiviteteve të peshkimit tradicionale dhe artizanale është vendimtar për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Mesdheut.

KRYETAR
Vangjush Dako



aktorët kryesorë për ruajtjen dhe përmirësimin e "peizazhit dhe burimeve të detit", ashtu si bujqësia është garanci për ruajtjen dhe rritjen e peizazheve rurale dhe burimeve. Nga kjo pikëpamje, zhvillimi i aktiviteteve të peshkimit tradicionale dhe artizanale është vendimtar për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Mesdheut.

Durrës, data 25. 7. 2019

ALFRED MULLARAJ


Kryetar i Këshillit të Qarkut



aktorët kryesorë për ruajtjen dhe përmirësimin e "peizazhit dhe burimeve të detit", ashtu si bujqësia është garanci për ruajtjen dhe rritjen e peizazheve rurale dhe burimeve. Nga kjo pikëpamje, zhvillimi i aktiviteteve të peshkimit tradicionale dhe artizanale është vendimtar për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Mesdheut.

Durrës, data 25.07.2019


Roland NASTO
Prefekti i Qarkut Durrës



25/07/2019 Arjan Demir

**Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit
dhe Akuakultures
Ministria e Bujqësisë**





Kapiteneria e Portit
Durrës

25.07.2019

Matilda Nasri

Drejtore Ekzekutive

Shoqata Shqiptare e Turizmit



25/07/'19

ARJANA KALLI

Administratore

Agjencia Turistike "Dea Lines"

25/7/2019



Latif Doda f.

Kryetar

Shoqata "Peshkimi-Rodoni"

Durrës

25.7 019

SSHQATA: "PESHKIMI-
RODONI" DURRËS-AL. &
KRYETAR Z. LATIF DODA

Kryetar i Shoqatës

“L.A.G” – Ishëm

Durrës

Data: 25.07.2018

Sulejman Haxhiu
1.08.18